



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 22 Prill 2021

Nr: 28

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 17, PARAQITUR  
NË KQZ NË DATËN 22.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, z. Kastriot Gurra;

**OBJEKT:** Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 17, të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, z. Kastriot Gurra me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 235, datë 14.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar, vendimi nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe udhëzimi nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Librazhd”.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



## VËREN:

Subjekti ankues kryetari i Bashkisë Librazhd, z. Kastriot Gurra ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 17 regi., datë 22.04.2021.

Në mbledhjen e datës 22.04.2021, ora 18:00, pas relativitetit të z. Elvin Lako dhe diskutimit të subjektit ankues, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 17 nuk i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor, pasi është paraqitur në datën 22.04.2021 pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërkohë që vendimi objekt kundërshtimi është marrë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 14.04.2021. Nga verifikimi i sistemit të gjurmimit të dërgesave të Postës Shqiptare rezulton se Kryetari i Bashkisë Librazhd z. Kastriot Gurra ka marrë dijeni në datën 16.04.2021. Pra, z. Gurra e ka depozituar kërkesën ankimore jashtë afatit. Në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “b” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronjat “b” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

## V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 17, datë 22.04.2021, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Librazhd, z. Kastriot Gurra, për shkak se është paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

